<p>3. Në qoftë se librat dhe regjistrimet e tatimpaguesit kanë humbur apo janë shkatërruar ose ekzistojnë rrethana tjera që bëjnë të pamundur përcaktimin e detyrimit tatimor, Drejtori i Përgjithshëm do të bëjë një vlerësim bazuar në një parashikim. Parashikimi duhet të bazohet në mjetet, të ardhurat qarkulluese, shpenzimet e prodhimit, shpenzimet krahasuese, dhe metodat tjera direkte dhe indirekte që lidhen me llogaritjen e detyrimit tatimor.</p> <p>4. Në qoftë se regjistrimet e një personi të vetë-punësuar kanë humbur apo janë shkatërruar ose ekzistojnë rrethana tjera që bëjnë të pamundur përcaktimin e shumës së kontributeve për pension të detyrueshme, Drejtori i Përgjithshëm mund të bëjë një vlerësim të kontributeve për pension të barabartë me nivelin e detyrimit të kontributeve për periudhën e mëparshme mujore ose tremujore.</p> <p>5. Vlerësimi për tatimet e mbajtura nga paga do të bëhet në të njëjtën mënyrë dhe do t'i nënshtrohet dispozitave dhe kufizimeve të njëjta që janë të zbatueshme për tatimet të cilat nuk janë mbajtur nga paga.</p> <p>6. Tatimpaguesi ka barrën e provës lidhur me të provuarit se kryerja e ndonjë vlerësimi nga Drejtori i Përgjithshëm është e gabuar dhe barrën për të provuar se shuma e ndonjë vlerësimi të tillë është e pasaktë.</p>	<p>3. If a taxpayer's books or records have been lost or destroyed or other circumstances exist that make a determination of a tax liability impossible, the Director General shall make an assessment based on an estimate. The estimate must be based on assets, turnover, production costs, comparative costs, and other direct and indirect methods that are relevant for calculating the tax liability.</p> <p>4. If the records of an employer or self-employed person are lost or destroyed or other circumstances exist that make a determination of the amount of required pension contribution impossible, the Director General may make an assessment of pension contributions equal to the level of contributions due for the previous monthly or quarterly period.</p> <p>5. An assessment for withholding taxes shall be made in the same manner and subject to the same provisions and limitations that are applicable to taxes that are not withheld at the source.</p> <p>6. The burden of proving that the making of any assessment by the Director General is erroneous and the burden of proving that the amount of any such assessment is incorrect shall be on the taxpayer.</p>	<p>3. Ako poreski obveznik, OSL knjige ili evidencije su izgubljene ili uništene ili postoje druge okolnosti koje čine utvrđivanje poreske obaveze nemoguć, generalni direktor će napraviti procenu na osnovu procene. Procena mora biti zasnovana na imovinu, promet, troškove proizvodnje, uporedne cene, kao i drugih neposrednih i posrednih metoda koji su relevantni za obračun poreske obaveze.</p> <p>4. Ako evidencije poslodavca ili samostalno zaposleni su izgubljena ili uništena ili postoje okolnosti koje čine određivanje iznosa obavezne penzijskog doprinosa nemoguće, generalni direktor može da proceni penzijskih doprinosa jednak nivo doprinosa duguju za prethodni mesec ili tromesečni period.</p> <p>5. Procena za zadržavanje poreza se izvodi na isti način i pod istim odredbama i ograničenja koja se odnose na poreze koji nisu zadržani na izvoru.</p> <p>6. Teret dokazivanja da je pravljenje bilo kakve procene od strane generalnog direktora je pogrešna i teret dokazivanja da je iznos bilo koje takve procene netačan biće na poreskog obveznika.</p>
--	--	--



<p>7 Aty ku të dhënat e ATK-së përmbajnë informata të mjaftueshme mbi një detyrim të padeklaruar për një periudhë tatimore, ATK bazuar në këto të dhëna mund të bëjë një vlerësim të menjëhershëm. Procedurat që duhet të ndiqen në lidhje me zbatimin e këtij neni do të rregullohen me akt nënligjor. Kur një individ deklaron një shumë të të ardhurave të cilat janë t pamjaftueshme të mbështesin shpenzimet e tij apo saj të dala për konsumum personal, ATK mund të rillojarisë të ardhurat e individëve bazuar në shpenzimet e dala nga individ, duke marrë parasysh të ardhurat e periudhave të kaluara.</p> <p>8. Për përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, tatimpaguesit i lejohet zbritje nga të ardhurat bruto për shpenzimet e bëra dhe të paguar brenda ose jashtë vendit, nëse ato janë bërë gjatë periudhës tatimore në tërësi dhe ekskluzivisht përkitazi me veprimtarinë e tij ekonomike dhe nëse ato janë të dokumentuara si shpenzime dhe pagesa të bëra.</p> <p>9. Kur një tatimpagues çregjistrohet (vullnetarisht apo ndryshe), regjistrimi është refuzuar nga ATK shkaku se tatimpaguesi nuk ka mundur ta gjendet, apo regjistrimi i tatimpaguesit është anuluar në pajtim me dispozitat e Nenit 23, çregjistrim i tillë, refuzim regjistrimi, apo anulim regjistrimi duhet të publikohet nga ATK duke shpall njoftim në mediat e shkruara ditore në Kosovë</p>	<p>7. Where the TAK data contain sufficient information on an unfiled liability for a tax period, TAK may make an immediate assessment based on this data. The procedures to be followed with regard of application of this Article shall be regulated by a sub-legal act. Where an individual declares an amount of income that is insufficient to support his or her expenses incurred for personal consumption, TAK may recalculate the income of the individual on the basis of expenses incurred by the individual, taking into account income of previous periods.</p> <p>8. For determination of taxable income, the taxpayer is allowed a reduction from gross income for costs paid in or outside the country, if these costs in full or in part are in connection with economic activity performed during that tax period and if those costs are supported by evidence to prove the costs incurred and the payments made.</p> <p>9. Where a taxpayer has been de-registered (voluntarily or otherwise), registration has been refused by TAK because the taxpayer was unable to be located, or the taxpayer's registration has been cancelled in accordance with the provisions of Article 23, such de-registration, registration refusal, or registration cancellation shall be publicized by TAK by posting notice in print media of</p>	<p>7. Gde PUK podataka sadrži dovoljno informacija o unfiled odgovornost za poreski period, PUK može da odmah procene na osnovu ovih podataka. Postupke koje treba sprovesti u pogledu primene ovog člana uredjuje se podzakonskim aktom. Gde pojedinac objavljuje iznos prihoda koji je dovoljan da podrži svoje troškove za ličnu potrošnju, PUK može preračunati dohodak pojedinca na osnovu troškova od strane pojedinca, uzimajući u obzir prihod od prethodnog perioda.</p> <p>8. Za utvrđivanje oporezivog prihoda, poreski obveznik je dozvoljeno smanjenje bruto prihod iz za troškove plaćene u ili van zemlje, ako se ovi troškovi u celosti ili delimično je u vezi sa ekonomskim delatnost u tom poreskom periodu, a ako tih troškova su podržani od dokaza da se dokaze troškove i uplate.</p> <p>9. Gde je poreski obveznik je de-registrovan (dobrovoljno ili drugačije), za registraciju je odbijen od strane PUK jer je poreski obveznik nije mogao da bude lociran, odnosno poreskog obveznika, registracija je otkazan u skladu sa odredbama člana 23, što je de-registracija, registracija odbijanje ili poništenje registracije objavljuje se po PUK slanjem obaveštenja u štampanim medijima</p>
---	--	---



<p>si dhe në faqen zyrtare të internetit të ATK-së. Çdo shpenzim i aplikueshëm në të ardhurat tatimore, apo kreditim i zbritshëm i TVSH-së, që i atribuohet transaksioneve që përdorin numrin fiskal të këtyre bizneseve që janë çregjistruar, i është refuzuar regjistrimi, apo regjistrimi i tyre është anuluar nuk do të njihen nga ATK dhe deklaratat tatimore do të rregullohen në përputhje me to në kontroll apo nga zbulimi i ATK-së.</p> <p>10. Për përcaktimin e detyrimeve tatimore, në rastin e prishjes, shkatërrimit dhe djegies së mallit për tu pranuar si shpenzime të veprimtarisë ekonomike, tatimpaguesi mungesën e mallit kërkohet ta dokumentoj me fakte të besueshme të lëshuara nga organet kompetente. Nëse sipas kërkesës së ATK-së, tatimpaguesi nuk dokumenton mungesën e mallrave, atëherë mallrat e tilla do të konsiderohen si mallra të shitura.</p> <p>11. Administrata Tatimore nuk do të ri-kontrollojë një periudhë tatimore që përfshinë llojin e njëjtë të tatimit që më herët është kontrolluar e për të cilën është lëshuar një njoftim vlerësim nga administrata tatimore, ku ri-kontrolli i tillë do të rezultojë në një rezultat të pafavorshëm për tatimpaguesin, përveç në rrethanat vijuese:</p> <p>11.1. kur të jenë zbuluar faktet e reja nga administrata tatimore të cilat nuk janë ditur dhe nuk kanë mundur arsyeshëm të</p>	<p>general circulation in Kosovo and on the TAK website. Any expenses applicable to income tax, or VAT input credits, attributable to transactions using the fiscal number of those businesses that have been de-registered, registration has been refused, or registration has been cancelled will not be recognized by TAK and tax declarations will be adjusted accordingly upon audit or discovery by TAK.</p> <p>10. For determination of tax, in case of damage, destruction or burning of goods to be accepted as economic activity costs, the taxpayer is required to document the lack of goods with persuasive documents issued by competent bodies. If the taxpayer does not document lack of goods following an appropriate request by TAK, then such goods shall be considered as goods sold.</p> <p>11. The Tax Administration shall not re-audit a tax period involving the same tax type that has previously been audited for which a notice of assessment has been issued by the tax administration, where such re-audit will result in an unfavorable result to the taxpayer, except in the following circumstances:</p> <p>11.1. new facts are discovered by the tax administration that were not known, and could not reasonably have been known, at</p>	<p>opšte promet na Kosovu i na PUK sajtu. Bilo rashodi odnose na porez na dohodak, odnosno PDV unos kredita, moze pripisati transakcije korišćenjem fiskalne broj onih preduzeća koji su de-registrovan, registracija je odbijeno ili registracija je otkazan neće biti priznata od strane PUK i poreske deklaracije će biti prilagodjen u skladu sa tim nakon revizije ili otkriće PUK.</p> <p>10. Za utvrđivanje poreza, u slučaju oštećenja, uništenja ili gori od robe koja se prihvaćena kao privredne delatnosti troškove, poreski obveznik je dužan da dokumenta nedostatak robe sa ubedljivom dokumenta koja su izdata od strane nadležnih organa. Ako poreski obveznik ne isprave nedostatak robe posle odgovarajući zahtev PUK, onda takva roba smatra se roba koja je prodana.</p> <p>11. Poreska uprava neće ponovo revizija poreski period koji uključuje isti porez tip koji je ranije bio revizija za koju obaveštenje ocenjivanja je izdat od strane poreske uprave, gde su ponovo revizije će rezultirati nepovoljnim rezultat poreskom obvezniku, osim u sledećim slučajevima:</p> <p>11.1. nove činjenice su otkrivene od strane poreske uprave koji nisu bili poznati, a nije mogao razumno je</p>
--	--	--



<p>dihen, në kohën e kontrollit dhe mos-hapja e rastit do të ishte mungesë serioze administrative;</p> <p>11.2. kur ka evidencë për mashtrim, shpërdorim, marrëveshje të fshehtë, fshehje e provave apo keqinterpretim i fakteve materiale;</p> <p>11.3. rasti i mbyllur që përmban një gabim të definuar qartë e material i bazuar në një pozitë të vendosur të administratës tatimore i cili ka ekzistuar në kohën e kontrollit.</p> <p>Çdo rihapje e një kontrolli të mbyllur i nënshtrohet miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së bazuar në evidencë të dokumentuar duke mbështetur bazën për rihapje.</p> <p>12. Në kuptim të vlerësimit të detyrimeve tatimore, kriteret dhe dokumentet që kërkohen për pranimin e shpenzimeve nga paragrafët 8 dhe 9 të këtij Neni, si dhe kushtet për ndryshimet e vlerësimeve të Drejtorit të Përgjithshëm dhe hipjes së kontrolleve të mbyllura, do të rregullohen më akt nënligjor.</p> <p style="text-align: center;">Neni 20 Kufizimet kohore për vlerësimet</p> <p>1. Duke iu nënshtuar paragrafit 2 të këtij Neni, të gjitha tatimet duhet të vlerësohen brenda gjashtë viteve nga data kur deklarata</p>	<p>the time of audit and failure to re-open the case would be a serious administrative omission;</p> <p>11.2. there is evidence of fraud, malfeasance, collusion, concealment, or misrepresentation of material fact;</p> <p>11.3. the closed case involved a clearly-defined, substantial error based on an established tax administration position which existed at the time of the audit.</p> <p>Any re-opening of a closed audit is subject to the approval of the Director General of TAK based on documented evidence supporting the basis for the re-opening.</p> <p>12. In the context of assessment of tax liability, the terms and requirements for acceptance of costs from paragraphs 8 and 9 of this Article, as well as the conditions for amendments of Director General assessments and re-opening of closed audits, shall be regulated by a sub-legal act.</p> <p style="text-align: center;">Article 20 Time limits for assessment</p> <p>1. Subject to paragraph 2 of this Article, all taxes must be assessed within six years of the date the tax declaration to which the</p>	<p>poznato, u vreme revizije i neuspeh da ponovo otvori slučaj će biti ozbiljan administrativni propust;</p> <p>11.2. postoje dokazi prevara, malverzacija, tajne sporazume, skrivanje ili lažno materijala činjenica;</p> <p>11.3. zatvoren slučaj uključeni jasno definisane, značajne greške na osnovu osnivanja poziciju poreske uprave koji je postojao u vreme revizije.</p> <p>Bilo ponovno otvaranje zatvorenih revizije podleže odobrenju generalnog direktora PAK na osnovu dokumentovanih dokaza kojima se potkrepljuju osnova za ponovno otvaranje.</p> <p>12. U kontekstu procene poreske obaveze, uslove i zahtjeve za prihvatanje troškova iz stava 8. i 9. ovog člana, kao i uslove za izmenu generalnog direktora ocena i ponovno otvaranje zatvorenih revizije, uredjuju se podzakonskim aktom.</p> <p style="text-align: center;">Član 20 Vremenski rokovi za procenu</p> <p>1. Prema stavu 2. ovog člana, svi porezi moraju biti ocenjeni u roku od šest godina od dana poreske prijave na koju se odnosi</p>
--	---	---



<p>tatimore me të cilën lidhet vlerësimi ka qenë obligues, apo datën kur është paraqitur deklarata, cilado qoftë më e vona.</p> <p>2. Drejtori i Përgjithshëm mund të bëjë vlerësimin në çdo kohë në rastin kur:</p> <p>2.1. një person, nuk ka dorëzuar deklaraten tatimore</p> <p>2.2. një person, me synim të shmangies së tatimeve, ka dorëzuar një formular tatimor; apo</p> <p>2.3. sjellje mashtruese e një personi të tretë ka çuar në nën-raportimin e tatimit apo mbi-raportimin e kreditimeve.</p> <p style="text-align: center;">Neni 21 Vlerësimet në rast rreziku</p> <p>1. Drejtori i Përgjithshëm mund të bëjë një vlerësim tatimesh në rast rreziku në rastin kur Drejtori i Përgjithshëm konsideron se mbledhja e tatimit apo ndëshkimit që bëhet detyrim i pagueshëm është në rrezik sepse personi po përgatitet të shmangë tatimin duke braktisur Kosovën, transferuar mjetet, ndërprerë biznesin ose duke ndërmarrë veprime tjera që do të rrezikojnë mbledhjen e tatimit nëse nuk bëhet një vlerësim rreziku. Një vlerësim në rast rreziku mundet të bëhet po ashtu në rast të konfiskimit të mallrave pa origjinë sikurse është paraparë në nenin 59. mund të ngrihet ankesë e drejtpërdrejtë në Bordin e Pavarur për Rishqyrtim.</p>	<p>assessment relates was due, or the date the declaration was submitted, whichever is later.</p> <p>2. The Director General may make an assessment at any time where:</p> <p>2.1. a person has failed to deliver a tax declaration;</p> <p>2.2. a person has delivered a tax form with the intent of evading tax; or</p> <p>2.3. fraudulent behavior of a third person has led to an understatement of tax or overstatement of credits</p> <p style="text-align: center;">Article 21 Jeopardy Assessments</p> <p>1. The Director General may make a jeopardy assessment of tax or penalty where the Director General considers that the collection of tax or penalty that will become due is in jeopardy because a person is about to evade taxation by fleeing Kosovo, transferring assets, ceasing business or taking other actions that will jeopardize collection of the tax unless a jeopardy assessment is made. A jeopardy assessment may also be made in the case of seizure of goods without origin as provided in Article 59. may be appealed directly to the Independent Review Board.</p>	<p>procena je zbog, ili datum deklaracije je podnet, šta god je kasnije.</p> <p>2. Generalni direktor može da proceni u svakom trenutku gde je:</p> <p>2.1. lice je propustio da dostavi poresku prijavu;</p> <p>2.2. osoba je isporučio poreski obrazac sa namerom da se izbegne porez, ili</p> <p>20.2.3. nepoštenog ponašanja trećeg lica je dovelo do nepotpuno poreza ili preterivanje kredita.</p> <p style="text-align: center;">Član 21 Procene opasnosti</p> <p>1. Generalni direktor može da proceni opasnosti od poreza ili kazni, gde generalni direktor smatra da je naplata poreza i kazne koje će biti zbog je u opasnosti, jer je čovek o tome da se izbegne oporezivanje bežanjem Kosova, prenos sredstava, prestanak poslovanja ili uzimanje druge akcije koje će ugroziti prikupljanje poreza, osim ako ugrožena procena je napravljena. Procena ugroženosti može se u slučaju zaplene robe bez porekla, kao što je predviđeno u članu 59., moze se zaliti može se direktno apelovao na nezavisne pregled odbora.</p>
--	--	--



<p>2. Supozohet ligjërisht se mbledhja e tatimit që bëhet detyrim i pagueshëm është në rrezik, nëse ekziston dyshim i arsyeshëm se tatimi ishte, apo do të, shmangët dhe nëse rrethanat e kësaj shmangieje tregojnë se detyrimi tatimor nuk do të zgjidhet.</p> <p>3. Një ankesë kundër vlerësimit në rrezik të bërë nga Drejtori i Përgjithshëm nuk shtyn ekzekutimin e vlerësimit sipas Nenit 22.4.</p> <p style="text-align: center;">Neni 22 Njoftim vlerësimi</p> <p>1. Në qoftë se Drejtori i Përgjithshëm bën një vlerësim të tatimit, ose një vetë-vlerësim nga tatimpaguesi nuk është i shoqëruar me shumën e tërësishme të detyrimit tatimor, Drejtori i Përgjithshëm do t'i lëshojë një Njoftim Vlerësim personit i cili ka detyrim tatimor.</p> <p>2. Njoftimi i Vlerësimit po ashtu do të përmbajë informatat vijuese:</p> <p>2.1. emrin e tatimpaguesit;</p> <p>2.2. numrin identifikues të tatimpaguesit;</p> <p>2.3. datën e njoftimit;</p> <p>2.4. lëndën dhe periudhën tatimore ose periudhat me të cilat lidhet njoftimi;</p> <p>2.5. shumën e tatimit të vlerësuar,</p>	<p>2. It is legally assumed that collection of tax that will become due is in jeopardy, if there is a reasonable suspicion that the tax was, or will be, evaded and if the circumstances of the evasion indicate that the tax liability will not be settled.</p> <p>3. An appeal against the Director General's jeopardy assessment does not postpone the execution of the assessment according to Article 22.4.</p> <p style="text-align: center;">Article 22 Assessment Notice</p> <p>1. If the Director General makes an assessment of tax, or the self-assessment by the taxpayer is not accompanied by the full amount of tax due, the Director General shall deliver an Assessment Notice to the person liable for the tax.</p> <p>2. The Assessment Notice shall contain the following information:</p> <p>2.1. the name of the taxpayer;</p> <p>2.2. the taxpayer identification number;</p> <p>2.3. the date of the notice;</p> <p>2.4. the matter and tax period or periods to which the notice relates;</p> <p>2.5. the amount of assessed tax, sanctions,</p>	<p>2. je zakonski se pretpostavlja da je prikupljanje poreza koji će dospjeva je ugrožena, ako postoji osnovana sumnja da je porez, ili će biti, izbjegao i ako okolnosti ukazuju da je izbegavanje poreske obaveze neće biti rešeno.</p> <p>3. Protiv generalnog direktora, OSL ugrožena procena ne odlaže izvršenje procene u skladu sa članom 22.4.</p> <p style="text-align: center;">Član 22 Procena Obaveštenje</p> <p>1. Ukoliko generalni direktor donosi procenu poreza, ili samo-procena koju poreski obveznik nije u pratnjipun iznos poreza, generalni direktor dostavlja procenu Obaveštenje za lice odgovorno za porez.</p> <p>2. Procena Obaveštenje treba da sadrži sledeće informacije:</p> <p>2.1. ime poreskog obveznika;</p> <p>2.2. poreskog obveznika identifikacioni broj;</p> <p>2.3. Datum obaveštenju;</p> <p>2.4. predmet i poreski period ili periode na koje se odnosi obaveštenje;</p> <p>2.5. iznos procenjenih poreza, sankcija i</p>
---	---	---



<p>sanksionet dhe interesin; 2.6. një sqarim të shkurtër të vlerësimit; 2.7. kërkesën për pagesë të shumës që përbën detyrim; 2.8. vendin dhe mënyrën e pagesës së shumës që përbën detyrim; dhe 2.9. procedurat e ankesës.</p> <p>3. Tatimpaguesi, brenda 10 ditëve pasi të jetë dorëzuar njoftimi, do të paguajë shumën që përbën detyrim në vendin e cekur në njoftim. Shumat për pagesë do të përfshijnë tatimin, sanksionet dhe interesin e shtuar deri në ditën dhe përfshirë ditën e pagesës.</p> <p>4. Në rast të vlerësimit në rast rreziku sipas Nenit 21, Drejtori i Përgjithshëm mund të kërkojë pagesën e menjëhershme të tatimit dhe të ndërmarrë menjëherë mbledhjen e detyrueshme për të siguruar pagesën e detyrimit tatimor të pagueshëm.</p> <p style="text-align: center;">Neni 23 Anulimi i dokumenteve tatimore</p> <p>1. Drejtori i Përgjithshëm mund të anulojë dokumentet tatimore të lëshuar nga ATK në qoftë se konstatohet se janë bërë shkelje të legjislacionit tatimor</p> <p>2. Drejtori i Përgjithshëm mund të publikojë një njoftim në gazetat e përgjithshme ditore dhe në faqen e internetit të administratës</p>	<p>and interest; 2.6. a brief explanation of the assessment; 2.7. a demand for payment of the amount due; 2.8. the place and manner of payment of the amount due; and 2.9. the appeal procedures.</p> <p>3. The taxpayer shall, within 10 days after the notice is delivered, pay the amount due at the place stated in the notice. The amount payable shall include the tax, sanctions, and accrued interest up to and including the date of payment.</p> <p>4. In the event of a jeopardy assessment under Article 21, the Director General may demand immediate payment of tax and take enforced collection immediately to secure the payment of taxes due.</p> <p style="text-align: center;">Article 23 Cancellation of Tax Documents</p> <p>1 The Director General can cancel any tax document issued by TAK if it is determined any violation of tax legislation.</p> <p>2. The Director General may publish a notice in newspapers of general circulation and on the tax administration website when a</p>	<p>interesa; 2.6. kratko objašnjenje o proceni; 2.7. zahtev za isplatu iznosa zbog; 2.8. mesto i način uplate iznosa, zbog, i 2.9. proceduralne žalbe.</p> <p>3. Poreski obveznik, u roku od 10 dana od dana obaveštenja isporučuje, plati iznos duga na mesto navedeno u obaveštenju. Iznos plaća obuhvata porez, sankcija i obračunatu kamatu do i uključujući dan uplate.</p> <p>4. U slučaju opasnosti procene na osnovu člana 21, generalni direktor može zahtevati odmah plaćanja poreza i da prinudne naplate odmah da bi obezbedila naplatu poreza zbog.</p> <p style="text-align: center;">Član 23. Opoziv Poreske dokumenata</p> <p>1. Generalni direktor može da otkáže bilo koji dokument poreza izdaje PAK ako se utvrdilo kršenje poreskih propisa.</p> <p>2. Generalni direktor može da objavi obaveštenje u novinama opšte cirkulacije i na sajtu poreske uprave kada je poreski</p>
---	--	---



<p>tatimore kur është tërhequr certifikata e një tatimpaguesi ashtu që bizneset tjera të jenë në dijeni për tërheqjen dhe ndikimin e saj në mundësinë e tyre për të hyrë në transaksione ligjore me atë biznes. Mundësia për të publikuar njoftime të tilla gjithashtu do të përfshijë autorizimin për të publikuar njoftimin për mos-lëshim të një numri fiskal siç është paraparë në nenin 11, nëse administrata tatimore nuk ka qenë në gjendje të verifikojë ekzistencën apo adresën e një entiteti i cili ka dorëzuar dokumentet e regjistrimit në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve.</p> <p>3. Për zbatim të paragrafit 1 të këtij neni Ministri për Ekonomi dhe Financa nxjerr akt nënligjor për përcaktimin e kushteve dhe mënyrën e anulimit të dokumenteve tatimore dhe lëshimi i dokumenteve publike.</p> <p style="text-align: center;">Neni 24 Detyrimi në rastet e veprës penale në fushën e tatimeve</p> <p>Kushdo që kryen vepër penale në fushën e tatimeve apo merr pjesë në atë mënyrë të bashkëkryerjes, shtytjes apo ndihmës do të jenë bashkërisht dhe individualisht i detyruar për ikje të tatimeve. Detyrimi po ashtu do të përfshijë interesin në përputhje me Nenin 28.</p> <p style="text-align: center;">Neni 25 Detyrimi i personave përgjegjës</p>	<p>taxpayer certificate has been withdrawn so that other businesses can become aware of the withdrawal and its impact on their ability to engage in legal transactions with that business. The ability to publish such notices will also include the authority to publish a notice of non-issuance of a fiscal number as provided in Article 11, if the tax administration has not been able to verify the existence or address of an entity that has submitted registration documents to the Business Registration Agency.</p> <p>3. For the implementation of paragraph 1 of this Article, the Minister of Economy and Finance shall issue a sub-legal act to define the conditions and way of cancellation of tax documents and issuance of public notices.</p> <p style="text-align: center;">Article 24 Liability in cases of Criminal Tax Offense</p> <p>Whoever commits a criminal tax offense, or participates in such by way of co-perpetration, incitement or assistance shall be jointly and severally liable for the evaded taxes. The liability shall also include interest according to Article 28.</p> <p style="text-align: center;">Article 25 Liability of responsible persons</p>	<p>obveznik sertifikat je toliko povučen da druge firme mogu da postanu svesni povlačenja i njen uticaj na njihovu sposobnost da učestvuju u pravnom prometu sa tom poslu . Sposobnost da se objavi takva obaveštenja će takodje uključiti ovlašćenje da objavi obaveštenje o ne-izdavanje fiskalnog broja kao što je predvidjeno u članu 11, ukoliko Poreska uprava nije bila u mogućnosti da potvrdi postojanje ili adresu lica koje je podneo za registraciju dokumente Agencije za privredne registre.</p> <p>3. Za sprovođenje stava 1. ovog člana, Ministar Ekonomije i Finansija će doneti podzakonski akt za definisanje uslova i način raskida poreskih dokumenata i izdavanje javnih obaveštenja.</p> <p style="text-align: center;">Član 24 Odgovornost u slučaju krivičnog dela poreske</p> <p>Ko učini krivično djelo poreske, ili učestvuje u takvom načinu saradnje izvršenje, izazivanje ili pomoć će solidarno odgovorni za izbjegao poreze. Odgovornost obuhvata i interesa u skladu sa članom 28.</p> <p style="text-align: center;">Član 25 Odgovornost odgovornog lica</p>
--	--	---



<p>Personat e përmendur në paragrafët 1 dhe 2 të Nenit 16 do të jenë bashkërisht dhe veçmas të detyrueshëm në lidhje me ato obligime tatimore që nuk janë plotësuar, për shkak të shkeljes me dashje apo nga pakujdesia e madhe e shkeljes së detyrimeve të caktuara mbi ta duke rezultuar në tatime që, nuk janë vlerësuar ose nuk janë paguar apo nuk janë vlerësuar ose nuk janë paguar me kohë. E njëjta do të zbatohet në rastet kur kreditimet dhe rimbursimet tatimore të paguara pa baza ligjore sipas kushteve të fjalisë së parë të këtij Neni. Detyrimi po ashtu do të përfshijë interesin në përputhje me Nenin 28.</p> <p style="text-align: center;">Neni 26 Vlerësimi i detyrimit të personit të tretë ose për personat e tretë</p> <p>1. Drejtori i Përgjithshëm mund të kryej një vlerësim të detyrimeve të personit të tretë sipas Neneve 24 ,dhe 25 të këtij Ligji, si dhe kundër personave përgjegjës të përshkruar në paragrafët 4 dhe 5 të këtij Neni. Nenet 19, 20, 21 dhe 22 do të aplikohen mutatis mutandis.</p> <p>2. Barra e provës për vlerësim të drejtë dhe për arsyetimin e detyrimeve të personit të tretë do të jetë mbi Drejtorin e Përgjithshëm.</p> <p>3. Pagesa e shumës së detyrimit të personit të tretë mund të kërkohet vetëm kur mbledhja e detyrueshme ndaj pasurisë së luajtshme dhe të</p>	<p>The persons referred to in paragraphs 1 and 2 of Article 16 shall be jointly and severally liable with respect to those tax obligations which are not fulfilled due to a willful or gross negligent breach of the duties imposed on them resulting in taxes which are not assessed or are not paid or are not assessed or paid on time. The same shall apply in cases where tax credits and refunds are paid without legal grounds under the conditions of sentence 1 of this Article. The liability shall also include interest according to Article 28.</p> <p style="text-align: center;">Article 26 Assessment of a third person's liability</p> <p>1. The Director General may make an assessment of a third person's liability under Articles 24 and 25 of this Law, as well as against responsible persons described in paragraphs 4 and 5 of this Article. Articles 19, 20, 21 and 22 shall apply mutatis mutandis.</p> <p>2. The burden of proof for the correct assessment and the reasoning of a third person's liability shall be on the Director General.</p> <p>3. The payment of the amount of a third person's liability may only be required where the enforcement against the taxpayer's</p>	<p>Lica iz stava 1. i 2. člana 16 treba da solidarno odgovorni u odnosu na one poreske obaveze koje nije ispunio zbog namerno ili iz nehata bruto kršenje dužnosti nametnuo im je rezultiralo poreza, koji se ne ocenjuje i nisu plaćeni ili nisu pravo vrednovala ili troškovi plaćaju na vreme. Isto važi u slučajevima kada su poreske olakšice i naknade plaća, bez pravnog osnova u uslovima kazne 1. ovog člana. Odgovornost obuhvata i interesa u skladu sa članom 28.</p> <p style="text-align: center;">Član 26. Procena treće lice, OSL odgovornost</p> <p>1. Generalni direktor može da proceni trećeg lica, OSL odgovornost prema članu 24. i 25. ovog zakona, kao i protiv odgovornih lica opisanih u paragrafima 4 i 5 ovog člana. Članovima 19, 20, 21 i 22 primenjuju se mutatis mutandis.</p> <p>2. Teret dokazivanja za ispravne procene i mišljenja treće lica, OSL odgovornost će biti na generalnog direktora.</p> <p>3. Plaćanje iznosa od trećeg lica, OSL odgovornost može se zahtevati u kojoj izvršenje protiv poreskog obveznika, OSL</p>
--	---	--



<p>paluajtshme të tatimpaguesit nuk ka qenë e suksesshme apo kur mund të supozohet në mënyrë të arsyeshme se mbledhja e detyrueshme ndaj pasurisë së luajtshme apo të paluajtshme të tatimpaguesit nuk do të shpije në zgjidhje të detyrimeve tatimore. Ky kufizim nuk do të zbatohet kur detyrimi është i bazuar në kryerjen e veprës penale në fushën e tatimeve nga personi, apo kur detyrimi i personit për tatim ka rezultuar nga mosmbledhja, mosmbajtja në burim apo mospagesa e tatimeve të tilla sikurse është paraparë në paragrafët 4 dhe 5 të këtij Neni.</p>	<p>movable or immovable property was not successful or where it can be reasonably assumed that enforcement against the taxpayer's movable or immovable property would not lead to a settlement of the tax liability. This restriction shall not apply where the liability is based on a person's commission of a criminal tax offense, or where the person's liability to tax results from the taxpayer's failure to collect, withhold or pay over such taxes as provided in paragraph's 4 and 5 of this Article.</p>	<p>pokretnu ili nepokretnu imovinu nije bila uspešna, ili gde se može razumno pretpostaviti da za sprovođenje protiv poreskog obveznika, OSL pokretnom i nepokretnom imovinom bi ne dovede do rešenja poreske obaveze. Ovo ograničenje se ne primenjuje gde je obaveza zasnova se na lice, OSL izvršenje krivičnog dela poreza, ili ako lice, OSL poreske obaveze prema rezultatima iz poreskog obveznika, OSL neuspeh za prikupljanje, zadrži ili plati više takvih poreza kako je utvrđeno u stav, OSL 4 i 5 ovog člana.</p>
<p>4. Kur një entitet juridik, apo çdo organizatë ndryshe nga një ndërmarrje afariste personale, nuk ka mbajtur në burim, nuk ka mbledhur apo nuk ka paguar tatimin e mbajtur në burim apo tatimin e mbledhur, çdo person përgjegjës për mbajtje në burim, mbledhje apo pagim të tatimit të tillë dhe i cili me paramendim nuk mban në burim, nuk mbledh apo nuk paguan atë tatim, do të jetë personalisht i detyrueshëm nga pasuritë e tij apo saj për shumën e tatimit të mosmbajtur, të mosmbledhur apo të mospaguar. Për qëllime të këtij paragrafi, paramendim do të përcaktohet nëse personi(at) gjykohet (konsiderohet) të jetë përgjegjës për të paguar, i autorizuar për të paguar, i urdhëruar për të paguar, apo i lejuar për të paguar kreditorët tjerë kur ai person e ka ditur, apo është dashur ta dijë se mbajtja në burim e tatimit apo mbledhja e tatimit nuk është mbledhur, mbajtur në burim</p>	<p>4. Where a legal entity, or any organization other than a personal business enterprise, has failed to withhold, collect, or pay over a withholding tax or collected tax, any person responsible for withholding, collecting or paying over such tax, and who willfully fails to withhold, collect, or pay over that tax, shall be personally liable from his or her own assets for the amount of the tax not withheld, collected or not paid over. For the purposes of this paragraph, willfulness shall be determined if the person(s) deemed responsible paid, authorized to be paid, directed to be paid, or allowed to be paid other creditors when that person knew, or should have known, that the withholding tax or collected tax had not been collected, withheld, or paid over.</p>	<p>4. Gde pravno lice, ili bilo koje organizacije, osim ličnog poslovnog preduzeća, nije uspeo da zadrži, prikupi, ili plati više poreza po odbitku ili prikupljaju porez, svako lice koje je odgovorno za zadržavanje, prikupljanje i plaćanje preko takav porez, i koji namerno ne zadrži, prikupi, ili plati više od tog poreza, biće lično odgovorni iz sopstvene imovine za iznos poreza nije uskratio, prikupljeni ili ne plaća više. Za potrebe ovog stava, willfulness utvrđuje da li je lice (a) smatra odgovornim plaćeni, ovlašćen da se plati, usmereni da se plati, ili je dozvoljeno da se plati ostalih poverilaca, kada je to lice znao, ili trebalo da zna, da je porez po odbitku ili prikupljaju porez nisu prikupljeni, uskratio, ili plaća preko.</p>



<p>apo paguar.</p> <p>5. Kur një entitet juridik, apo çdo organizatë ndryshe nga një ndërmarrje afariste personale, nuk ka mbajtur në burim, nuk ka mbledhur apo nuk ka paguar një kontribut pensional, çdo person përgjegjës për mbajtje në burim dhe pagesë në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës të kontributeve të tilla pensionale, dhe i cili me paramendim nuk mban në burim, nuk mbledh apo nuk paguan çdo kontribut të tillë, do të jetë personalisht i detyrueshëm nga pasuritë e tij apo saj për shumën e kontributeve të mos-mbajtur, të mos-mbledhur apo të mos-paguar në Trust. Për qëllime të këtij paragrafi, paramendim do të përcaktohet nëse personi(at) gjykohet (konsiderohet) të jetë përgjegjës për të paguar, i autorizuar për të paguar, i urdhëruar për të paguar, apo i lejuar për të paguar kreditorët tjerë kur ai person e ka ditur, apo është dashur ta dijë se kontributeve pensionale nuk janë mbledhur, mbajtur në burim apo paguar.</p> <p>6. Shuma e detyrimit të paraparë në paragrafët 4 dhe 5 të këtij Neni është e kufizuar në shumën e tatimit të pa mbledhur, të pa mbajtur në burim apo të papaguar. Nëse, pas vlerësimit të detyrimit kundër personave përgjegjës, entiteti juridik, apo organizata ndryshe nga një ndërmarrje afariste personale, paguan atë tatim që ka qenë obligues për të mbledhur, mbajtur në burim apo paguar, shumën e vlerësuar kundër personave</p>	<p>5. Where a legal entity, or any organization other than a personal business enterprise, has failed to withhold, collect, or pay over a pension contribution, any person responsible for withholding and paying to the Kosovo Pension Savings Trust such pension contributions, and who willfully fails to withhold any such contributions or who willfully fails to pay any withheld contributions shall be personally liable from his or her own assets for the amount of the contribution not withheld or not paid over to the Trust. For the purposes this paragraph, willfulness shall be determined if the person(s) deemed responsible paid, authorized to be paid, directed to be paid, or allowed to be paid other creditors when that person knew, or should have known that the pension contributions had not been collected, withheld, or paid over.</p> <p>6. The amount of the liability provided in paragraphs 4 and 5 of this Article is limited to the amount of tax not collected, withheld, or paid over. If, after assessing this liability against responsible persons, the legal entity, or organization other than a personal business enterprise, pays the tax that was due to be collected, withheld, or paid over, the amount assessed against the responsible persons shall be abated and any liens filed shall be released.</p>	<p>5. Gde pravno lice, ili bilo koje organizacije, osim ličnog poslovnog preduzeća, nije uspeo da zadrži, prikupi, ili plati više doprinos penzija, svako lice odgovorno za zadržavanje i plaćanje za Kosovo Trust penzione štednje što doprinosi penzija, a koji namerno ne da zadrži sve što je doprinos ili koji namerno ne uplati bilo koji zadržani doprinos će biti lično odgovorni iz sopstvene imovine za iznos doprinosa nije zadržan ili nije platio preko poverenja. Za potrebe ovog stava, utvrđuje da li je lice (a) smatra odgovornim plaćeni, ovlašćen da se plati, usmereni da se plati, ili je dozvoljeno da se plati ostalih poverilaca, kada je to lice znao, ili trebalo da zna da penzijskog doprinosa nije su prikupljeni, uskratio, ili plaćene preko.</p> <p>6. Iznos obaveze predviđeno u paragrafima 4 i 5 ovog člana ograničena na iznos poreza koji nisu naplaćeni, uskratio, ili plaća preko. Ako, nakon procene ove odgovornosti protiv odgovornih lica, pravnog lica ili organizacije osim lična poslovna preduzeća, plaća porez koji je trebalo da bude prikupljena, uskratio, ili plaćene preko, iznos procenjene protiv odgovornog lica biće izleči i bilo liens podneo će biti</p>
--	---	---



<p>përgjegjës do të hiqet dhe çdo barrë e dorëzuar do të lirohet. Sikurse është përkufizuar në këtë ligj, termi 'tatim' përfshinë tatimin dhe kontributet e pagueshme në ATK.</p> <p>7. Shuma e detyrimit të paraparë në paragrafët 4 dhe 5 të këtij Neni mund të vlerësohet kundër një apo më shumë personave që gjykohet të jenë përgjegjës për dështimin e entiteti juridik apo organizatës tjetër për të mbledhur, mbajtur në burim apo për të paguar tatimin e mbajtur në burim apo të mbledhur. Megjithatë, shuma totale e tatimit të mos-mbajtur në burim të mos-mbledhur apo të mos-paguar mund të mblidhet vetëm një herë. Kur shuma e tatimit të plotë të jetë paguar nga ndonjë entitet, organizatë, person përgjegjës, apo kombinim i këtyre, çdo shumë e mbetur e ndëshkimit obliguese nga personat përgjegjës do të hiqet dhe çdo barrë e dorëzuar do të lirohet. Sikurse është përkufizuar në këtë ligj, termi 'tatim' përfshinë tatimin dhe kontributet e pagueshme në ATK.</p> <p>8. Ministri do të nxjerr një akt nënligjor për të përshkruar aplikimin e këtij Neni dhe procedurave që do të ndiqen në vendosjen e detyrimit për palën e tretë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 27 Pagesat</p>	<p>As defined in this law, the term 'tax' includes tax and contributions payable to TAK.</p> <p>7. The liability provided in paragraphs 4 and 5 of this Article may be assessed against one or more persons deemed to be responsible for the failure of the legal entity or other organization to withhold, collect or pay over a withholding or collected tax. However, the total amount of tax not withheld, collected or paid over can be collected only one time. Once the full tax amount has been paid by any entity, organization, responsible person, or combination thereof, any remaining tax amounts due from responsible persons shall be abated and any liens filed shall be released. As defined in this law, the term 'tax' includes tax and contributions payable to TAK.</p> <p>8. The Minister shall issue a sub-legal act to describe the application of this Article and procedures to be followed in establishing third-person liability.</p> <p style="text-align: center;">Article 27 Payments</p>	<p>objavljeni. Kako je definisano u ovom zakonu, termin "poreski" obuhvata poreza i doprinosa plaća PUK.</p> <p>7. Odgovornost je propisano u stavovima 4. i 5. ovog člana može biti procenjeno protiv jedne ili više osoba smatra da je odgovoran za propust pravnog lica ili druge organizacije da zadrži, prikupi ili plati više po odbitku ili prikupljaju porez. Medjutim, ukupan iznos poreza nije uskratio, prikupljeni ili plaćene preko može se preuzeti lično samo jedan put. Kada je pun porez je iznos plaćen od strane bilo kog lica, organizacije, odgovorno lice, ili njihova kombinacija, preostale porez iznosi od odgovornih lica zbog biće izleči i bilo koje liens podnio će biti objavljeni. Kako je definisano u ovom zakonu, termin "poreski" obuhvata poreza i doprinosa plaća PUK.</p> <p>8. Ministar će doneti podzakonski akt da opiše primenu ovog člana i postupke koje treba sprovesti u uspostavljanju trećeg lica odgovornosti.</p> <p style="text-align: center;">Član 27 Isplate</p>
---	---	--



<p>1. Çdo tatim që përbën detyrim dhe që duhet t'i paguhet ATK-së është një borxh ndaj ATK.</p> <p>2. Çdo person që ka detyrë t'i paguajë tatime ATK-së sipas legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë, do të paguajë tatimin e tillë në kohën dhe vendin e specifikuar në legjislacionin e tillë ose rregullat e zbatimit, pa njoftim ose kërkesë nga ana e ATK-së.</p> <p>3. Çdo person i cili është bërë përgjegjës nga tatimpaguesi të mbajë në burim , të llogarisë dhe të paguajë çdo tatim në emër të atij tatimpaguesi sipas legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë, pa njoftim apo kërkesë nga ATK, do të paguajë tatimet e tilla në kohën dhe vendin e caktuar në legjislacionin e tillë ose rregullat e zbatimit.</p> <p>4. Secili punëdhënës i cili ka detyrë të japë kontribute pensioni në emër të të punësuarve të tij dhe të mbajë nga paga kontributet e pensionit nga të punësuarit e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi me lidhje me mbi pensionet në Kosovë do t'i paguajë kontributet e tilla në afatin e përcaktuar në legjislacionin e tillë ose rregullat e zbatimit.</p> <p>5. Personat e vetë-punësuar të cilët kërkohet të kryejnë kontributet për pension në përputhje me legjislacionin në fuqi me lidhje me mbi pensionet në Kosovë do të paguajnë si kontributet e punëdhënësit ashtu edhe</p>	<p>1. Any tax that is due and payable to TAK is a debt due to TAK.</p> <p>2. Any person required to pay any tax to TAK under the legislation applicable in Kosovo shall, without notice or demand from TAK, pay such tax at the time and place specified in such legislation or implementing rules.</p> <p>3. Any person who is made responsible by the taxpayer to withhold, account for and pay over any tax on behalf of that taxpayer under the legislation applicable in Kosovo shall, without notice or demand from TAK, pay such tax at the time and place specified in such legislation or implementing rules.</p> <p>4. Each employer who is required to make pension contributions on behalf of its employees and to withhold pension contributions from its employees pursuant to legislation in force with respect to pensions in Kosovo shall pay such contributions at the time specified in such legislation or implementing rules.</p> <p>5. Self-employed persons who are required to make pension contributions pursuant to legislation in force with respect to pensions in Kosovo shall pay both the employer contribution and the employee contribution on</p>	<p>1. Bilo kojeg poreza koji je zbog i plaća PUK je dug zbog PUK.</p> <p>2. Svako lice treba da plati bilo koji porez PUK po propisima koji važe na Kosovu mora da, bez prethodnog obaveštenja ili zahteva iz PUK-a, mora da plati takav porez u vreme i mesto iz takvog zakona ili pravila o izvršenju.</p> <p>3. Svako lice koje je odgovorno je poreski obveznik da zadrži, za račun i da plati više od bilo kojeg poreza na ime poreskih obveznika da po propisima koji važe na Kosovu mora da, bez prethodnog obaveštenja ili zahteva iz PUK-a, mora da plati takav porez u vreme i na mestu odredjenom u tom zakona ili pravila o izvršenju.</p> <p>4. ach poslodavca koji je obavezan da doprinosi penziju na ime svojih zaposlenih i obustavu obračunatih doprinosa penziju od svojih zaposlenih u skladu sa zakonima na snazi u vezi sa penzijama na Kosovu mora da plati ove doprinose u vreme navedeno u te zakone ili pravila o izvršenju.</p> <p>5. Samozaposlenih lica koja se zahteva da doprinosu penzija u skladu sa zakonima na snazi u vezi sa penzijama na Kosovu plaća i doprinos poslodavca i zaposlenog doprinos u svoje ime u vreme navedeno u te zakone</p>
---	---	--



<p>kontributet e të punësuarit në afatin e përcaktuar në legjislacionin e tillë ose rregullat e zbatimit.</p> <p>6. Përveç rastit kur parashikohet e kundërta në udhëzimet administrative, të gjitha tatimet do të paguhen në bankën apo institucione tjera financiare, të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës Kosovës (BQK).</p> <p>7. Pavarësisht nga çdo dispozitë tjetër në këtë Nen ose në këtë ligj, aty ku shuma e tatimit për pagesë sipas një deklarate tatimore është 3 Euro ose më pak, ose shumë tjetër të tillë të vogël e përcaktuar nga Drejtori i Përgjithshëm, ATK do të trajtojë tatimin e pagueshëm si vlerë zero.</p> <p>8. Përveç rastit kur përcaktohet ndryshe me shkrim nga Drejtori i Përgjithshëm, zyrtarët tatimorë e kanë të ndaluar të marrin çfarëdo lloj pagese që lidhet me ndonjë tatim.</p> <p style="text-align: center;">Neni 28 Interesi</p> <p>1. Në qoftë se çfarëdolloj shume e ndonjë tatimi e administruar nga ATK sipas legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë nuk është paguar deri në datën e fundit të përcaktuar për pagesë, tatimpaguesi do jetë i detyruar të paguajë interes.</p>	<p>their behalf at the time specified in such legislation or implementing rules.</p> <p>6. Unless otherwise specified in administrative instruction, all taxes shall be paid to a bank, or other financial institution, licensed by the Central Bank of the Republic of Kosovo (CBK) .</p> <p>7. Notwithstanding any other provision in this Article or in the present law, where the amount of tax payable under a tax declaration is 3 Euro or less, or such other small amount as determined by the Director General, TAK shall treat the tax payable as zero.</p> <p>8. Unless designated to do so in writing by the Director General, tax officials are prohibited from receiving any payment in respect of any tax.</p> <p style="text-align: center;">Article 28 Interest</p> <p>1. If any amount of any tax administered by TAK under legislation applicable in Kosovo is not paid by the last date prescribed for payment, the taxpayer shall be liable for interest.</p>	<p>ili pravila o izvršenju.</p> <p>6. Osim ako je drugačije navedeno u administrativnim uputstvom, svi porezi će biti plaćeni za banke ili druge finansijske institucije, licenciran od strane Centralne banke Republike Kosova (CBK)..</p> <p>7. Bez obzira na bilo koju drugu odredbu ovog člana ili u ovom zakonu, gde je iznos poreza prema poreskoj izjavi 3 evra ili je manje, ili druge male količine, kao određuje generalni direktor, PUK mora tretirati kao nula poreza.</p> <p>8. Osim ako nije odredjen to u pisanoj formi od strane generalnog direktora, poreski službenici su zabranjeni prima neku isplatu u pogledu bilo kojeg poreza.</p> <p style="text-align: center;">Član 28 Interes</p> <p>1. Ako bilo koji iznos bilo kojeg poreza administrira PUK po propisima koji važe na Kosovu ne plaća do poslednjeg dana propisanog za uplatu, poreski obveznik će biti odgovoran za kamate.</p>
---	---	---



